Vdekje fashizmit — Liri Popullit!

Poštarina plačena u gotovu
Taksa postale e pagueme

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

DEL DY HERE NE JAVE:
…ITEN DHE TE DIELLEN

Redakcija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din.
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN
Drejtori pergjegjes HANA

Botim i posaçem Nr. 132 | PRISHTINE, 4 Gusht 1948 | Qmimi 2 dinarë

Referat'i Komitetit Qendruer te Partis Kumuniste te Jugosllavis mbi punen agitacjono-propagandistike

Referat'i shokut Millovan Gjillas

— Në vashdim te punes së Kongresit të Peste te PKJ shoku Millovan Gjillas tha referatin e Komitetit Qendror të Partis Komuniste të Jugosllavis mbi punen agitacjono—propagandistike. Shoku Gjillas, i cili, te dalmen ne tribunë, u-përshendet me entuzjazem, ne referatin e tij tha:

«Shokë e shoqe,

Referati mbi agitacjonin e propaganden, si dhe të gjithë referatet e tjera te KQ, ndahet ne tri pjese: pjesa e pare përfshin periudhen ne pragun dhe mbas konferences së Pestë, d.m.th.—periudhen e luftes per perforcimin ideologjik, politik e organizativ te Partis: pjesa e dytë perfshin periudhen e luftes Nacional—çlirimtare, d.m.th — periudhen për perzanjen e okupatorit dhe krijimin e pushtetit popullner: pjesa e tretë përfshin periudhen e mbas—luftes, d.m.th. perjudhen e luftes për ndertimin e Vendit në bazen e re, socjaliste.

Tue kalue mandej ne pjesen e pare te referatit te tij, shoku Gjillas spikatë çashtjet kryesore që, para lufte, janë shtrue përpara agitacjonit e propagandes se Partis ne lidhje me detyret e përgjithëshme të Partis.

«Çashtja e unitetit ideologjiko-politik te Partis, çashtja e luftes per fitoren e marksizëm—lenjinizmit ne rradhet e saja, ka qenë nji nga detyret kryesore përparà se cilës asht gjetë, ne vitin 1938, udhëheqsija e re, e formueme nen kryesin e shokut Tito. Substanca e kësaj detyre qendronte këtu: t'u ipej grushti definitiv botëkuptime ve anmiqësore oportuniste, revizjoniste, trockiste etj., që ekzistojshin kryesisht qark Partis, por përpiqeshin me e pengue të shendoshunit e shpejtë të Partis.

Partija atëhere ndodhej ne gjendjen e konsolidimit ideologjik, politik e organizatave, i cili kryhej si ne baze të luftes për unitetin e rradhve te Partis e spastrimin e partis nga mbeturinat e frakcjonistave, grupistave dhe te gjithë elementave te huej anmiqë, ashtu edhe ne baze të luftes per përfitimin e masave popullore. Te gjitha fuqinat reakcjonare të Jugosllavis se vjeter, tue e parandie fortunën, u-mobilizuen kundra Partis. Ato i vuen ne veprim edhe te gjithë anmiqët e maskuem e tinzakë te klases puntore. Gjithashtu u-çuen kundra sajë edhe të gjithë ata njerez te luhatshëm, te cilet i drojshin fortunes dhe vështirësinave, te pa — evituesh me ne luften qe afrohej: ata te cilet i kapi friga për shkak te rolit qe Partija e kishte marre përsiper ne ket luftes.

Tue folë mandej mbi luftën e Partis për unitetin ideologjik, shoku Gjillas spikatë veprimtarin e Partis ne likuidimin e mbeturinave të Simamarkoviçizmit si faze ideologjike e frakcjonit të djatht. Partija i shpartalloi me sukses teprical e mbrame te Simamarkoviçizmës dhe frakcjonet e dikurshme «te majta» te ngjajshme me te. Mirëpo borgjezija, tue kerkue, edhe mjete tjera, ma te rrafinueme, për shkatrrimin e unitetit të Partis, nepërmjet futjes ne te të spijujve e provokatorve, asht mundue me e shkatrrue organizativisht Partin dhe me shkaktue pështjellim ne linjen e Partis. Tue i demaskue këta spijuj e provokatore. Partija zhvilloi nji punë të palodhshme ideologjike e politike per t'a nxjerrë ne shesh, para antarve dhe puntorve te ndershem, vepren e atyne shkatrrimtare, te maskueme nen «politiken» dhe «ideologjin. Njikohësisht Partija demaskojë energjikisht rrolin spiju te gruptheve trockiste e u dha atyne nji grusht vendimtar. Në luften për unitetin ideologjik te Partis, nji rrezik serioz shenjonte edhe grupi i intelektualve që kanë qene pështjellë rreth revistes «Pečat». Në lidhje me «Peçatin», para Partis u-shtrue seriozisht çashtja e luftës për mbrojtjen e themeleve theorike te marksizëm—lenjinizmit.

Kur u-qiruen llogorinat me sukses kundra grupit rreth «Počatit» iu dha nji grusht vendimtar anmiqëve t'unitetit ideo—politik dhe lëvizjes puntore.

Tue folë mbi arsyen për te cilen Partija i ka mposhtë të gjitha këto botekuptime të llojllojshme anmike, shoku Gjilals thotë:

«Në **ketë luftë Partija triumfoi** për arsye se **bërthame e sajë udheheqëse ka qenë e armatosun me shkencen e marksizëm—lenjinizmit dhe e përkushtueme thellësisht kësaj shkence.** (Duertrokitje frenetike) **Partija ka pasë asi kuadrash udhëheqëse, te cilet kane qene t'aftë t'a ruejne e t'i dalin zot ne të gjitha çashtjet marksizëm—lenjinizmit përpara anmiqeve te këtij.** (Aprovim enthuzjazt).

Partija, mandej ka mnejtë me triumfue dhe ka triumfue ne ket **luftë shumvjeçare për arsye se antaret e sajë, ndonse theor kisht pa mjaftunisht te naltësuem kanë qene thellësisht te përkushtuem Partis dhe çashtjes se komunizmit.**

Partija trimfoi ket lufte edhe per arsye sepse e ka lidhë gjithmone drejtë luften ideologjike me praktiken revolucjonare, tue zbulue si kuptimin politiko—praktik te luftes theorike e ideologjike, ashtu edhe kuptimin ideologjik te luftes praktiko—politikes.

Ne referat, mandej, spikatet puna e KQ **me shokun Tito** ne kryen n'edukimin ideologjik t'antarve dhe kuadrit drejtues te Partis. Nën kushtet e vështira ilegale, Partija zhvilloi punen n'edukimin marksisto—lenjinist t'antarve te sajë. Përforcimi i unitetit ideologjik e politik te Partis dhe ngritja e nivelit ideologjik te kuadrave te Partis, krahas me realizimin e solidaritetit te sajë organizativ e aftëson Partin për t'i pritë e gatshme ngjarjet e mdhaja, e aftësoi kuadrin udhëheqës te Partis t'orjentohet vetë, që ne bazë te linjes se përgjithshme te Partis, t udhëheqevet.

Partija zhvilloi gjithashtu nji punë te palodhshme për përfitimin politik te turmave punuese, per demaskimin e politikës se regjimeve reakcjonare borgjeze faqe masave punuese. Partija i demaskoi te gjitha masat e drejtueme kundra pamavarësis se Vendit, kundra klasës puntore dhe masave punuese. Në referat, mandej, paraqitet lufta, ideo—politike e Partis në çashtjen nacionale, mandej lufta kundra «ideologjive» të ndryshme «katundare», çka ka qenë nji nga parakushtet e pjesëmarrjes masovike të katundaris s'onë, nën udhëheqjen e Partis, në kryengritjen popullore.

Mandej shoku Gjillas ven në dukje vendin që ka zanë n'agitacjonin dhe propagandën t'onë popullarizimi i Bashkimit Sovjetik, fuqis së tij, sukseseve të tija, si dhe lufta politike për aleancen e Jugosllavis me Bashkimin Sovjetik. (Kjo paraqitje e shokut Gjillas asht përcjellë me duertrokitje frenetike të gjata).

Mandej ai kaloi në paraqitjen e mjeteve dhe metodave si dhe formave organizative me anën e të cilave atëhere Partija ka zhvillue luften ideologjike dhe politike për masat popullore. Partija i ka kombinue mjetet, metodat e format ilegale të punës agitacjono—propagandistike, me ato legale dhe gjysëm—legale.

Tue folë mbi politiken kulturale të Partis ne periudhën para luftes, shoku Gjillas thotë:

«Kjo politikë, e para, qëndronte ne punën e Partis ndër organizatat kulturale, masovike, ne shtimjen e theoris së përparueme, revolucjonare, të kulturueme e socjaliste në përmbajtjen e punës se ketyne organizatave»

Në referat mandej, flitet mbi zhvillimin e veprimtaris botuese legale dhe ilegale, kështu që ne ket periudhë ka dalë nji seri veprash te marksizëm—lenjinizmit. Rreth Partis u-bashkuen nji seri puntoresh kulturalë përparimtarë. Në ket periudhë Partija shtroi si detyrë praktike edhe çashtjen e trashigimis kulturale. Përveç kesaj, nën udhëheqjen e Partis, u-zhvillue lufta për formimin e hartit të përparuem, proletar.

Në konkluzen e pjesës se parë te referatit te tij shoku Gjillas e përmbledhë punen e Partis ne fushen e agitacjonit dhe propagandës ne periudhën perpara luftes Nacjonal—çlirimtare.

«E para, Partija, ne sektorin e agitacjonit dhe propagandës, si dhe ne sektoret tjerë te punës se sajë, e ka mbajtë naltë dhe ne menyrë te pathyeshme flamurin e marksizëm—lenjinizmit ne rradhet e veta dhe ne lëvizjen puntore;

e dyta, lufta e suksesëshme ideologjike dhe politike e Partis ne rradhet e saja dhe ne masat popullore — ka qenë kusht esencjal për shpërthimin e kryengritjes popullore dhe qindrueshmenin ne këte».

I I

Mandej shoku Gjillas kaloi ne periudhen e luftës çlirimtare e tha:

«Mbas shkatrrimit te Jugosllavis se vjetër, ne prill, Partija, si e kemi pa nga referatet e shokut Tito dhe shokut Aleksandar Rankoviq, u-orjentue direkt ne pregatitjen e kryengritjes me armë. Në bazë te kësaj linjeje, agitacjoni dhe propaganda e Partis asht dashtë me u-marrë me problemet ideologjike dhe politike te kësaj pregatitje.

Detyra e parë e agitacjonit dhe propagandës ka qenë demaskimi sistematik i okupatorit, krimeve te tija dhe politikës se tij te coptimit te Jugosllavis. Partija, me te tanë forcën e sajë ideologike dhe politike, iu-përvesh kesaj detyre.

Partia iu deshke, simbas kushteve te ndryshme që u-krijuen me coptimin e Jugosllavis, me demaskue politikën e okupatorit — gjermanëve, italjanëve, bullgarëve e hungarezve e sherbtorve te shumnumert t'okupatorit. Ajo filloi me nji herë agitacjonin e gjallë dhe te papajtueshëm kundra krimeve t'ustashëve kroatë nder serbë, te çetnikve ndër myslimanë etj.; filloi luftën e rrepët për vllaznimin e bashkimin e popujve te Jugosllavis. Agitacjoni dhe propaganda, ne pragun e kryengritjes, nji kujdes te veçantë ia ka kushtue krijimit te Frontit t'unjisuem te të gjitha fuqive patriotike kundra okupatorit e trathtarve te mbrendëshem. Agitacjoni dhe propaganda e Partis i damkosi dhe i demaskoi njerzit udhëheqësa te Jugosllavis së vjeter, te cilet e sabotojshin krijimin e këtij fronti. Njikohësisht Partija e vuni ne dukje rolin e sajë udhëheqës ne ket front dhe ne luften Çlirimtare.

Në punen agitacjono—propagandistike Partija e ka theksue gjithashtu doemosdoshmenin e forcimit te fuqis morale dhe kompaktësis së popullit. N'agitacjonin e atëhershem, sidomos n'ate me gojë, ka qene shum e randesishme çashtja e damkosjes se trathtis dhe spijunazhit. Ne krijimin e unitetit moral dhe forcës morale të popullit ka pasë gjithashtu randësi te madhe ngjallja e traditave luftarake të popujve t'onë.

Ka qenë nevoja me armatose Partin me doktrinën marksiste—lenjiniste mbi kryengritjen, mbi strategjine e taktiken, mbi luften e revolucjonin. Këto kane qene çashtjet ideologjike kryesore të cilat Partija duhet t'i zgjidhte e ne te cilat asht dashte me thellue dhe shtue punen edukative n'organizatat e Partis. Dhe përnjimend, Partija, në punen e sajë, nepërmjet te studimit ma intensiv të vepres Stalinjane, «Mbi bazat e Lenjinizmit» dhe «Historis së PK(b) të BRSS» po armatosej ideologjikisht per betejen iminente.

Veçanërisht duhet vue ne dukje agitacjoni e propaganda e Partis mbas sulmit të Gjermanis kundra BRSS, ne momentin e pregatitjes direkte te kryengritjes. Fillë te nesërmen mbas ketij sulmi te pabesë, KQ, ne proklamaten e tij, caktoi vijen e Partis. Kjo ka tri karakteristika kryesore.

E para, Partija konkludoi se ne vojitet me fillue urgjentisht kryengritjen e përgjithëshme popullore — ne nji ane nga se tash jane krijue te gjitha kushtet per shpërthimin e sajë, dhe e dyta sepse kjo ka me qene edhe nji ndihmë per BRSS-n. (Te gjithë delegatet duertrokisin me entuzjazem).

E dyta, Partija e vuni ne, dukje rolin udhëheqës te klasës puntore ne luften iminente, tue thirrë këtu klasen puntore me i krye detyrimet e saja ndaj atdheut të socjalizmit—Bashkimit Sovjetik.

E treta, Partia, tue i tregue detyret e komunistave, vueni ne dukje rolin e saje udhëheqës ne kryengritje.

Ne ket linje Partija filloi me arme. Aparati agitacjono—propagandistik dhe organizatat e saja e per cuellen ket linje nepër mbarë vendin, tue i mobilizue masat popullore për luften me arme.»

Mandej shoku Gjillas flet per luften e palodhëshme dhe energjike te p ë r d i t s h m e kundra luhatjeve te llojeve te ndryshme dhe për qendreson ne rrugen e luftes me arme.

«Sistemi i punes agjitacjono—propagandistike te Partis, — thotë ai ma tutje, — asht ndryshue dhe

(Vazhdon ne faqen e dytë)

Vazhdim i referatit te shokut Millovan Gjillas

(Vijon nga faqja e parë)

zhvillue me ndryshimet dhe zhvillimin e luftes Nacjonal—çlirimtare, siç asht ndryshue edhe zhvillue përmbajtja e kësaj pune, por, në bazen e vete, ka mbete po ajo gjatë mbare luftes. Ka pasë edhe disa ndryshime ne bazat e disa krahinave e viseve të Jugosllavis dhe — nga vet kjo — edhe dallimin e punes agitacjono—propagandistike t'organizatave të Partis — porse këto ndryshime nuk e kanë ndrrue bazen ideologjike dhe organizative t'agitacjonit dhe propagandës te Partis, bazë e cila ka qenë e unjisueme për mbare vendin».

«Gjatë mbare luftes — thotë mandej shoku Gjillas — nder te gjitha organizatat e Partis n'ushtri ka qene i detyrueshëm studimi i marksizëm—lenjinizmit dhe linjes se Partis s'one. Pranë shtabeve jane organizue kurset e Partis, ne te cilat studjoheshin çashtjet themelore të lenjinizmit dhe problematika e luftes s'one nacjonal—çlirimtare. Në fillim të vitit 1943, prane shtabeve te disa divizjoneve dhe korpusave, KQ caktoi drejtuesa te veçante te kurseve si organe te vetat. Partija ka punue dite per ditë edhe n'edukimin ideologjik te masave së luftetarve jo-antare të Partis. Nuk ka mujtë me kalue asnji ngjarje politike, pak a shum e randesishme, nderkombtare, pa u-informue mbi te çdo njisi e ushtris s'one. Ky edukim politik asht krye, kryesisht, nepermjet te konferencave te çetave, ose, kur ngjarja ka qene e nji randesije te veçante, nepermjet te mbledhjeve te batalioneve dhe brigadave».

Mandej shoku Gjillas kaloi ne paraqitjen mbi punen ideo—politike dhe kulturale n'ushtri. Ajo ka ushtrue nji influencë politike kolosale jo vetem me luftat e veta heroike, jo vetem me rolin e saje çlirimtar, por edhe me punen e vete politike e kulturale ne popull.

Puna politike e kulturale asht zhvillue kudo ne territorin e çliruem. Bashke me këshillat Nacjonal—çlirimtare, edhe organizatat e Frontit popullor, rinis Popullore dhe frontit antifashist te grues përfaqësojnë gjithashtu nji formë te re jete politike. Nën kushte te vështira ilegale, Partija e ka zhvillue palodhmenisht kete pune edhe ne territorin jo të liruem, sidomos nder qytetet e mdha. Shoku Gjillas theksoi se Komiteti Provincjal i Partis Komuniste të Jugosllavis për Serbin, ne kushtet e vështira ilegale, shtypi Historin e PK(b) te BRSS.» Edhe organizatat e Kroacis dhe Slloveniës botuen, ne kushtet ilegale, «Historin e PK(b) te BRSS» dhe vepra tjera theorike.

«E tanë puna e Partis, si dhe pjesa agitacjono—propagandistike e kësaj pune, asht krye dhe zhvillue ne bazë të t'udhëhequnit të shendoshe, te centralizuem e unik, që, ne mënyrna te ndryshme, ç'prej fillimit deri ne mbarim te luftes Çlirimtare, ka realizue dhe zbatue Komiteti Qendruer.

T'udhëhequnit e unjisuem te Partis asht realizue edhe nepermjet te shtypit qendror etj. Ne vitin 1941, kur vatra kryesore e kryengritjes ndodhej ne Serbi, KQ botoi organin e Partis, «BORBEN». Per shkak te ofensivës anmike, n'Uzhice, qe nderpre botimi i «Borbes», por ne vitin 1942 ajo filloi me dale perseri ne Bosanska Krajina, ne katundin Drinica. Për shkak t'ofensives së IV, ajo nderpreu punën deri sa filloj përsëri me dalë në Beogradin e shl'ruem, ne nandor te vitit 1944.

Organi teoriko—politik i KQ — «Proleter», luejti rol te madh n'armatimin e Partis me linjen e drejtë politike. Ai sherbeu si nji mjet me nji vleftë pamatunisht te çmueshme ne luften ideologjike per praktiken e drejtë t'organizatave te Partis. Gjatë luftes dualën dy numra, nji ne Foçe, ne fillim te vitit 1942, e nji ne Dreniq, ne mbarrim te vitit 1942.

Përveç këtyne dy organeve centrale te Partis, kane dale edhe organe tjera centrale e edhe ata kane sherbye si mjet udhëheqjeje ne duer te KQ ne fushen e agitaconit dhe propagandës. Këtu hyejnë «Omladinska Borba», e cila e përpunonte linjen e KQ ne çashtjet e rinis, «Bilten Vrhonog Staba», ku asht dhanë gjykimi mbi gjendjen ushtarake dhe ushtarako—politike ne vend, »Nova Jugoslavija», e cila ka trajtue problemet politike dhe shtetnore, mbas sesjonit të Dytë t'AVNOJ-it, «Zena danas», ku asht perpunue linja për punen me gra etj.

Te gjitha udhëheqësinat nacjonale e provincjale te Partis, si dhe organet e tjera udhëheqëse ushtarake e politike, kane, tregue, gjithashtu, gjate luftes, nji kujdes të madh në botimin e shtypit te vet.

Ne të gjitha organet udhëheqëse centrale ka pasë, përveç te tjerash, edhe organe te punes politiko-propagandistike dhe kulturalo—arsimore.

Në sistemin e t'udhëhequnit të centralizuem t'agitacjonit dhe propagandës, nji rol te randësishem e ka luejtë edhe radjo—sherbimi i jonë. Ne saje të ndihmes së Bashkimit Sovjetik, asht organizue radjostacjoni «Slobodna Jugoslavija», «Slobodna Jugoslavija» ka qene nji mjet i fuqishem politike për popullarizimin e luftes s'onë përjashta, për informimin dhe ngrit jen politike të masave t'ona popullore. Në vjeshten e vitit 1943 KQ organizoi agjensin telegrafike «TANJUG», e cila sherbeu, gjithashtu, per popullarizimin e luftes s'onë.

Edukimi i kuadrave ne bazen e studimit dhe përvehtësimit të themeleve të marksizëm—lenjinizmit dhe te linjes së Partis ka pasë nji randësi kolosale për forcimin e unitetit ideo—politik të Partis ne luftes.

Në luften per te kuptuemit e drejtë të karakterit të luftes Nacjonal—çlirimtare agitacjonit dhe propagandes s'onë të Partis i asht deshtë me zgjidhe nji seri problemesh ideo-politike serioze. Shoku Gjillas përmendi taktiken infernale t'okupatorëve fashista dhe të veglave te tyne çetnike, ustashe dhe maçekiste, që kanë deshte me e ngushtue bazen e kryengritjes. Partija e jonë ka zhvillue gjithashtu luftë te palodhshme kundra taktikës s'okupatorit që synonte ngushtimin e luftës civile ne Vendin t'onë, si dhe kundra te gjitha pikpamjeve te gabueshme — s'ashtuquejtunës «fazë e dytë» dhe shtrembnimeve te tjera kësoji sektare dhe oportuniste.

»Çashtjen krijimit të vllazënimit dhe bashkimit te popujve te Jugosllavis dhe unitetit të masave te çdo popullit veç e veç, Partija e shtroi qysh ne ditën e parë te kryengritjes si nji nga çashtjet ma të randësishme, ma vendimtare. Ne punen e saje agitacjono-propagandistike, Partis i asht deshtë me luftue nji seri pengesash ideologjike e politike.

Partis i asht deshtë me i përballue rrjedhimet e randa te shtypjen së popujve joserbë nga serbomdhajt. Hegemonija asht çfrytëzue mjeshtrisht nga okupatorët fashista dhe veglat e tyne për perçamjen e bashkimit te popujve të Jugosllavis. Prandaj asht dashtë tue krijue vllazënimin luftarak te popujve t'onë, me e bindë pjesën e mbrapambetun te masave se lëvizja Nacjonal-çlirimtare nuk ka kurrgja te përbashket as me cbashkimin kombtarë që propagojshin klikat serbomdhaja,, as me luftën shoveniste te borgjezas se kombeve te shtypuna, porse kjo lëvizje don te thotë njikohësisht zhdukje e shtypjes nacjonale.

Artikulli i shokut Tito «Çashtja nacjonale ne Jugosllavi në dritën e luftës Nacjonal-çlirimtare» ka qenë nji armë e fuqishme ideologjike ne duer te Partis.

Agitacjoni e propaganda si edhe mbare puna e Partis ka pasë si detyre, përveç tjerash, me i ua hapë sytë masave me e mposhtë propaganden e okupatorit dhe veglave te tij, e cila nxiste urrejtjen vllavrasëse dhe ngacmonte luften vllavrasëse.. Ne ket çashtje, gjatë të tane kohes së luftes Nacjonal—çlirimtare — nga nji anë — dhe okupatorit, veglave të tij dhe qarqeve reakcionare t'Europes prenamore e agenturave të tyne jugosllave— nga ana tjetër. Vetëm nga forca dhe pjekunija politike e Partis s'one mvarej ne se çashtje nacjonale ne Jugosllavi do të jete nji leve e luftes Çlirimtare apo levë në duer t'okupatorit dhe aleatve te tij.

Ne vendet e ndryshme të Jugosllavis kjo çashtje asht shtrue ne menyre të ndryshme, arsye per të cilen edhe detyret e propagandes s'onë, ndonse të njajta ne substancë, kane qene, deri ne nji fare mase, specifike per disa vendes.

Mandej shoku Gjillas permendi luften që ka zhvillue Partija me anë te agitacjonit dhe propagandes, nder masat e popullit serb kundra tendencave hegomoniste serbombdhaja shtypëse, nder masat e popullit kroat kundra nacjonalizmit borgjez kroat, e nder masat e popullit, maqedon kundra pikpamjeve serbombdhaja si dhe bullgaromdhaja.

«Popullarizmi i BRSS dhe Armates së Kuqe dhe zhvillimi i dashunis ndaj tyne ka qenë — bashke me luften kundra okupatorit— përmbajtja kryesore e mbarë veprimtaris s'one agitacjono—propagandistike. Kjo veprimtari ka qenë aq e gjanë dhe e gjithanëshme sa kishte me u-dashtë nji referat i veçante per t'a paraqite.

Popullarizimin e BRSS Partija e ka kuptue si pjese përbamse të luftës për çlirim. Ajo i ka bindë masat se fati i popujve të Jugosllavis asht i pandashem nga fati e lufta e Bashkimit Sovjetik. Ajo e ka bindë popullin punues te Vendit t'onë se lufta me arme kundra okupatorit asht njikohësisht edhe nji detyrë ndaj luftes heroike të popujve të BRSS-s. Ajo e ka forcue ke populli besimin e patrandësbëm ne BRSS-s. Ajo i ka shpartallue ke masat paragjykimet mbi BRSS-n dhe u a ka skjarue misjonin historiko—botnor çlirimtar të BRSS. Besimi i Partis ne BRSS u-ba besimi i popullit. Bazen e mbare kësaj veprimtarije propagandistike e ka dhanë shoku Tito ne fjalimet dhe artikujt e tija të shumnumërta.

(Duertrokitje frenetike dhe brohoritje: «heroj Tito»).

Ndihma e BRSS ne pikpamje moralo—politike, sidomos çmimi i luftës s'onë nga shoku Stalin — gja qe asht e njoftun-ngriten moralin, besimin dhe krenarin e luftetarve dhe turmave t'ona popullore. Këto kane qene dekoratat ma te naltat,, këto u bane parulla lufte dhe fitoreje. Dhe me këte Partija i ka afrue popujt t'onë me BRSS-ën, e ka ngritë besimin e masave dhe përhapë frymen e kryengritjes.

Ma ne fund, Partija i ka kushtue gjithaj nji kujdes shum te madh luftes kundra propagandes së qarqeve reakcjonare engleze e amerikane dhe agenturave te tyne në Vendin t'one. Tue qendrue ne pikpamje t'unitetit të koalicjonit anti-hitlerjane, tue u ruejtë që mos t'i trazojë me asnji gja marrëdhanjet ne mes t'aleatëve, Partija e jone dhe lëvizja e jone çlirimtare, gjatë të tane kohes se luftes, kane zhvillue nji politikë anti—imperijaliste parimore konseguente, dhe nga pikpamja e kësaj politike — kane luftue s, kundra propagandës së qarqeve reakcjonare t'Anglis dhe Amerikës, ashtu edhe kundra praktikes së tyne me të cilën ata kanë ndihmue dhe udhëhequ bandat çetnike e tjera ne Vendin t'onë.

Mandej shoku Gjillas theksoi se agitacjoni e propaganda e Partis s'onë, gjatë te tane kohes se luftes, nuk e ka hjekë nga rendi i dites çashtjen e demaskimit të propagandes s'agenturave Anglo—Amerikane ne Vendin t'one si dhe propagandes zyrtare Anglo—Amerikane mbi t'ashtuquejtunin misjon çlirimtar t'aleatve te prendimit: ajo e ka zbulue para masave popullore qëllimin imperjalist të kësaj propagande.

«Tue dhane gjykimin mbi punën e Partis ne sektorin e agitacjonit e të propagandes gjate luftës Nacjonal—çlirimtare, duhet thanë:

E para, se zhvillimi dhe fitorja e luftes Nacjonal—çlirimtare kanë konfirmue edhe njiherë te gjithë saktësin dhe fuqin jetësore të shkences se Marksit, Engelsit, Lenjinit e Stalinit;

Të gjithe delegatet duertrokitën dhe aprovojnë me enthuzjasëm).

E dyta, se Partija, ne krye me KQ të PKJ, ka dijtë me e zbatue ne kushtet konkrete te Jugosllavis shkencen marksiste — lenjiniste, me gjete rugen e drejtë ne kushtet e komplikueme të revolucjonit t'one popullor e të luftes s'one Çlirimtare;

(Edhe këto fjale të shokut Gjillas janë përcjelle me aprovim frenetik).

E treta, se Idenat e Partis s'one, Idenat e marksizem—lenjinizmit, konkretizue e zbatue ne kushtet e luftes së proleterijatit dhe të masave punuese te Jugosllavis, kane triumfue mbi idenat e barbarve dhe opekurantistave fashista, e se ky triumf ideologjik asht pjesë përbase e atij triumfi qe marksizem—lenjinizmi e ka korre ne periudhën e luftës kundra fashizmit mbi ideologjin e robnuesave fashista e tjerë si këta;

(Perseri, aprovim frenetik i te gjithe delegatve).

E katerta, se Partija jonë, mbas si nuk asht bazue vetëm ne qëllimet e disa etapave të luftes, por edhe ne programin e luftes për socjalizem, per komunizem — ka realizue kushtet ideo—politike the melore për kalimin, ne kushtet e paqes, ne ndertimin e shoqnis socjaliste ne Jugosllavi.»

—III—

Në vazhdim të referatit te tij shoku Gjillas vijoi të thote:

«Pjesa e madhe e punes agitacjono—propagandistike asht dashtë, mbas luftes, t'orjentohet ne problemet e ndertimit dhe rregullimit organizativ te jetes politike, shoqnore e kulturale.

Kjo nuk don të thote se Partija nuk e ka zgjidhë problematikën ideologjike dhe politike që shtrohesh ne rendin e ditës. Pa zgjidhjen e kesaj problematike, pa luften e vazhdueshme, te përditshme ideologjike e politike kundra anmiqve te mbrendshem e te jashtëm nuk mund te mendohet as puna agitacjono-propagandistike e Partis—përmbajtje e së cies ajo asht — as puna e sektorve tjerë te veprimtaris së Partis. Por, rrethana që problemet me karakter organizativ kanë qenë domosdoshmenisht ne qendren e vemendjes t'organizatave te Partis, ka sjellë njifarë neglizhimi te luftës ideologjike, neglizhim jo vetem ke udhëheqësit e ulta, por edhe ke vet KQ i PKJ».

Mandej shoku Gjillas theksoi se problemet organizative me te cilat asht marrë Partija me perjudhën e mbas-luftës kane qenë te shumë shta; mandej organizimi i sektorit t'agitacjonit dhe propagandes i kohës se luftës u-tregue i pamjaftueshem ne kushtet e zhvillimit paqësuer; se asht dashte me e aftesue organizativisht Partin per te muejtë me ia hye dhe me e drejtue organizimin e jetës politike e kulturale te masave popullore e se Partija, me gjithse në ket pikpamje ka edhe te meta, i ka ngritë metodat e punës. Tue folë për dy tendenca te gabueshme që janë çfaqë ne zgjidhjen e çashtjes në fjalë ai tha se e para ka qenë — i ashtuquejtuni «mëvehtësim» i punes agitacjono-propagandistike, ndamja e kesaj pune nga pjesa tjetër e punes se Partis, dhe theksoi se ajo kryesisht asht eliminue. Tendenca tjetër e gabueshme ka qenë nënçmimi i punes agitacjono - propagandistike. »Partija e ka per detyre që, në t'ardhmen ma t'afërme, t'a likujdoje ket tendencë — theksoi shoku Gjillas.

Tue folë mbi punën e agitpropeve tue kritikue mendimet se agitpropet duhet te cenzurojne te gjitha e gjithshkafen dhe tue e përcaktue rolin e agitpropit shoku Gjilisa tha:

«Tue u-nisë nga ky rol i agitpropit si aparat i Partis, metodat e tij ne t'udhehequn kryesisht te jene: a) kudjcai i forte per ruejtjen e njisishmenis se punes se Partis; b) kolektivizmi ne pune (d. m. th. zgjidhja e te gjitha çashtjeve parimore e te reja nder mbledhjet e te gjithe shokve udhëheqësa t'aparatit — si t'agitpropit dhe anteve te liduna me te ase t'interesuem për ket çashtje, ashtu edhe rrethit te gjane te puntorve t'agitpropit dhe puntorve te tjere ne ket fushe; c) zhvillimi i punes ne te gjitha çashtjet me randesi, nepermjet te konferencave, konsultimeve etj.; d) zhvillimi — ne rradhe te pare me ane te shtypit — kritikes dhe autokritikes, luftes per anen ideologjike, per fitoren e ideologjia marksiste — nder te gjitha fushat e jetes ideologjike.

Tue qeke çashtjen e shtypit ne Vendin t'one, shoku Gjillas paraqiti keto shenime:

«Puna n'organizimin dhe ngritjen e shtypit ne kushtet e vendit te çliruem ka kerkue nxjerjen e nji numrit te madh gazetash, revistash dhe botimesh informative te reja. Kishem me shkue se teper larg sikur te tregojshem se si e ka zgjidhe Partija ket çashtje. Do t'apim pasqyren e per mbledhun te shtypit në vendin t'onë në tri vjetet e fundit: në vitin 1945 në Jugosllavi ka pasë vetem 97 gazeta, ne vitin 1946 — 156 gazeta, ne vitin 1947 — 216 gazeta e ne vitin 1948 — 240 gazeta. Nder keto gazeta, vetem nji numer fort i vogel (ato te kishes e disa tjera) nuk jane nen udhehegjen e Partis».

Mandej shoku Gjillas theksoi se lufta per anen ideologjike ne

(Vazhdon ne faqen e tretë)

Vazhdim i referatit te shokut Millovan Gjillas

(Vijon nga faqja 2)

shtypin t' one ka qene nji nga detyrat ma te randesishme te punes agitacjono - propagandistike te partis, se Partis i asht dashte me luftue kundra nji serije te metash ne shtyp. Ai u-ndal veçanerisht ne çashtjen e ngritjes se shtypit si arme kritike dhe autokritike e tha:

«Ngritja e shtypit si arme kritike dhe autokritike ka qenë gjith ashtu e ende asht gjithnji nji problem serioz. Tue e ngrite shtypin tone ne ket drejtim, Partis i asht deshtë me luftue si kundra tendencës autokritikes se hapet konstruktive ashtu dhe kundra tendences se qendrimit kritizues destruktiv ne lidhje me te metat, mungesat e gabimet. Tendenca e nençmimit te kritikes dhe autokritikes ka qendrue ketu: ne mos — vuemjen ne dukje te gabimeve dhe te metave ne punen e organizatave te Partis, organizatave masovike dhe enteve shtetnore; ne mos-tregimin e ketyne te metave ne mos-zbulimin e shkaqeve dhe fajtorve te vertete, ne mos-kerkimin e dhanjes te pergjegjesis per keto gabime. Persa i perket tendences tjeter, ajo asht çfaqe ne rritjen e teprueme t'anve te dobta, ne pergjithesimin e gabimeve dhe ne kurdisjen, ne baze te disa gabimeve-e nji sistemi te tane gabimesh, ne shkatrrimin edhe asaje qe asht pozitive bashke me ate negativen. Ne ngritjen e matutjeshme te shtypit t'one si arme kritike e autokritike duhet me u-ruejte si nga njena ashtu e te disa gabimeve-e nji sistema te dhe nga tjetra tendence».

«Ne kushtet e reja te mbasluftes- — vazhdoi shoku Gjilas, Partija u-gjet, ne fushen e veprimtaris botuese, para detyres s'organizimit te sistemit te ri te verprimtaris botuese dhe likuidimit te te vjetrit, para problemit te riorganizimit dhe përmirësimit te bazes teknike dhe shtruemjes se linjes drejtuese te punes botuese.

Rezultate te mbrrijtuna ne ket pikpamje janë te knaqëshme.

Në vendin t'onë asht likuidue veprimtarija botuese private. Parime drejtuese te veprimtaris s'onë botuese kanë qenë, kryesisht, dhe janë prap: 1) botimi i vepravе te klasikve te marksizmë-lenjinizmit sa ma tepër, tue sigurue përkthime sa ma te drejta; 2) botimi i publicistikës marksiste; 3) botimi i veprave solide nga shkencat e veçanta; 4) botimi i veprave letrare klasike t'ona dhe te hueja, letërsis s'onë e te huej realiste dhe moderne revolucjonare, ku letërsija e re sovjetike zen vendin e parë; 5) botimi i veprave klasike nga fushat e tjera te hartit; 6) botimi i teksteve sa ma korrekte për shkollat fillore, te mesme e te nalta.»

Mandej shoku Gjillas kaloi ne paraqitjen e luftës ideologjike që Partija ka zhvillue dhe zhvillon për formimin e kulturës socjaliste ke na. Asht dashtë — theksoi ai — me krijue dhe përforcue entet kulturale shtetnore, me organizue kujdesimin për puntoret kultural, me organizue organizatat masoviko-kulturale dhe punën në to etj. Mandej ai e paraqiti veprimtarin e Partis në ngjalljen e jetës letrare dhe artistike, në rezultatet e arrijtuna në transformimin kultural te katundit, no problemet e shkollave, dhe tha:

«Asht dashtë me vue dhe me ngritë ne nji bazë te re aparatin central, republikan etj. shtetnuer t'arsimit dhe shkencës, me krijue sistemin e ri shkolluer t'arsimit fillner, te mesëm dhe te naltë dhe me hartue programin e ri te ketij arsimi. Asht dashtë me luftue për frymen e re dhe metodiken e re te mësimit, megjithë faktin që në shkollat t'ona punon kryesisht kuadri i vjetër arsimuer. Rezultatet që kemi mbrrijtë në lamen e shkollave dhe te shkollimit janë keto: vendi i jonë tashma ka ma shum shkolla se sa ka pasë Jugosllavija e vjetër; janë krijue nji seri tipe te reja shkollash, sidomos në fushen e arsimit te mesem, dhe për nderdimin e tipit te ri socjalist te shkollimit janë shtrue, në bazë, themelet organizative, te cilat duhet te zhvillohen e te përsosen ma tutje.»

E mandej problemet e rregullimit ideologjik te shkollave dhe universiteteve t'ona, problemet e mësimit, teksteve dhe metodikës së punes, problemet e vuemjes në lëvizje te shkencës dhe jetës shkencore, problemet e luftes ideologjike kundra mistikes dhe cepteve anmike ne shkollat t'onatë gjitha këto kane nji randesi aq të madhe sa duhet të jene ne planin e parë te punes s'one ne periudhen që vjen» — theksoi ma per tej shoku Gjillas.

Tue kalue mandej ne çashtjet e punes s'ardhëshme ido—politike, shoku Gjillas vueni ne dukje nevojen që të bahet i pamundëshem çdo influencim i anmiqve te hapet ase tinzike te marksizem-lenjinizmit dhe nevojen e mprefjes së vigjillimit kundrejt tendencave revizjoniste eventuale.

«Për shkak t'atakimit të KQ të PK(b) te BRSS kundra Partis s'onë — tha ne vazhdim te referatit të tij shoku Millovan Gjillas — mund të ngjasë gjithashtu qe te çfaqet nji farë nënçmimi i zhvillimit dhe fitorve të mendimit theorik njikohtar ne BRSS-n. Këto çfaqje duhet me i gjykue si të padrejta jo vetem për shkaa të marrëdhanjes s'one të përgjithëshme me BRSS-n, por edhe për arsye se me këte pengohet zhvillimi ideologjik dhe përparimi i vendit t'one. Lufta iedologjike ne Bashkimin Sovjetik ne periudhen e kalimit ne shoqnin komuniste ka me pasë nji randësi shum te madhe per te gjitha vendet e sidomos për ne, në rrugen t'one të zhvillimit socjalist.

Perpunimin e domosdoshem dhe te ngutshem te problematikes s'one ne baze te doktrines se Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit shoku Gjillas e shtroi si nji nga detyret kryesore per luften e ndertimit te socjalizmit ke na. Nder detyret e matejme ma me randesi ne ket pike ai permendi ngritjen edhe perforcimin e patriotizmit te ri jugosllav, socjalist.

Ne referatin e tij shoku Gjillas mandej thekesoi veçanerisht luften kundra imperjalizimit si detyre e randesishme e agitacjonit e propgandes s'one dhe tha se edhe tash e mbrapa do t'u permbahemi parimeve qe i u jemi permbajte deri tash:

E para, me demaskue te gjitha tentativat dhe kombinacjonet e imperjalistave te drejtueme kundra vendit t'one.

E dyta, me luftue pathyeshmenisht per paqen demokratike, me demaskue fushaten luftenxitese, me demaskue politiken imperjaliste te shtypjes dhe robnimit te popujve te tjere dhe shkeljes te lireve demokratike dhe ketu tehu duhet te drejtohet kundra imperjalizmit amerikan, si eksponent kryesor i shtypjes imperjaliste dhe fushates luftenxitese.

E treta, me i dhane perkrahjen e gjithaneshme luftes se Bashkimit Sovjetik dhe kampit demokratik baze e te cilit ai asht.

Mbas kesaj shoku Gjillas dha disa karakteristika ma te randesishme te reakcjonit te tashem ideologjik dhe tha: „Kjo krize e thelle ideologjike te cilen sot e jeton kapitalizmi nuk asht vetem karakteristika e shkatrrimit te tij dhe e dekomponimit te tij, por edhe tentative e tij per t'a ndale, tue rrenue vetedijen njerzore, ecjen e jetes perpara, per t'a shtye mbarimin e vet".

Ne fund te referatit te tij shoku Gjillas e ceku akuzen e drejtueme nga Byroja Informative kundra PKJ dhe tha:

„Shoke e shoqe,

Lejomni, qe ne linjen e parashtrimit te deritashem, t'i ceke akuzat e bataeshme - qe ju i njifni - dhe tane ate fushate te paparim qe zhvillon shtypi komunist, organizue mbas rezolutes se Byros Informative, „Mbi gjendjen ne PKJ". Persa i perket kesaj, do t'i bie shum shkurt.

E para, Partija e jone ka muejte me i mposhte te gjitha veshtersinat dhe te tane kundershtaret sepse ka qene besnike ndaj marksizem-lenjinizmit. Ideologjija e drejte asht kushti themeltar i fitores. Keshtu ka qene e keshtu do te jete edhe mbas tashit.

E dyta, ne mes e Partis t'one dhe principeve te pergjitheshme marksiste-lenjiniste qe jane paraqite ne letrat e KQ te PK (b) te BRSS dhe Rezolutes se nalt-permendun te Byros Informative - nuk ka kurrfare ndryshimesh. Na nuk mohojme asnji prej atyne principevet dhe jo vetem kaq, por na as nuk e kemi shtremnue asnjenin prej tyue ne punen t'one praktike. Prandaj çdo kritike e punes se Partis s'one, qe bahet ne baze te letravet dhe Rezolutes se nalt-permendun, doemosdoeshmenisht, ne menyre te paevitueshme deshten apo s'deshten autoret e saje-shndrrohet ne te pavertete, ne trillim gabimesh dhe iluzjonesh, qe Partija e jone, ne realitet nuk i ka. Pikerisht ktu qendron edhe dobesija e atyne kritikavet. E perveç kesaje, shum kritikuesa t'one, tashma, ne nji menyre ase ne nji tjeter, kane shkele nji seri principesh, te parashtrueme ne letrat dhe Rezoluten ne fjale. Edhe ktu qendron dobesija e tyne. Kurse fuqija e Partis s'one qendron ktu, se praktika e saje, ne te cilen ajo, i permbahet besnikisht shkences se Marksit, Engelsit, Lenjinit e Stalinit, asht ne kundershtim te hapet me te gjitha ato per te cilat kritikohet. Çdo dite do te zbulohet, doemosdoeshmenisht, gjithnji ma forte, i tane apsurditeti i kritikes ne fjale, e tane drejtesija e politikes se Partis s'one.

(Kto paraqitje te shokut Gjillas u-pershndeten perseri frenetikisht dhe u-aprovuen me entuziazem).

E treta, per te gjitha kto qe thame, menyra ma e sigurta qe Partija te dale triumfuese nder kto veshtirsina asht -besnikija ndaj principevet te marksizem-lenizimit. Lufta e paperkulshme per kto principe, zbatimi i drejte krijues i ktyne principevet nder kushtet konkrete, i kane sjelle Partis s'one suksese ma te mdhaja se çdo Partije tjeter, perveç asaj te PK (b) te BRSS. Kjo ka me i sjelle suksese Partis s'one edhe tash e mbrapa, pra edhe ne ket lufte, dhe prej saje ka me dale me siguri ma e forte dhe ma e dlire.

E paverteta nuk ka muejte me fitue kurre ne levizjen puntore dhe doemosdoeshmenisht, ne fund te fundit, e verteta ka dale ne shesh edhe ma e ndritshme dhe e fuqishme.

Tue i u-permbajte ne menyre te patrandshme principevet te marksizem-lenjinizmit ne punen t'one, Partija e jone ka me dale prej ktyne veshtirsinavet-ma te vshtirat qe ka pase me faqe edhe ma te bardhe e fisnike, kurse kritikuesve te saje te padrejte ka me i u-dashte t'i shofin iluzjonet e tyne.

Duhet te jemi krenare qe jemi antare te nji kso Partije, e cila u-permbahet kaq paperkulshmenisht principevet te marksizem lenjinizmit e nuk u frigohet kurrfare veshtirsinavet ne luften per triumfin e tyne.

Rrnofte Partija e jone lavdiplote, e cila ne ditet ma kritike ka mbajte vendosmenisht nalte flamurin e pathyeshem te marksizem-lenjinizmit.

Rrnofte organiznesi i Partis Komuniste te Jugosllavis ne principet e marksizem-lenjinizmit, shoku Tito.

(Ekspozeja e shokut Gjillas ne lidhje me Rezoluten e Byros Informative u-nderpre disa here me radhe nga aprovime frenetike, duertrokitje dhe brohoritje shokut Tito dhe Partis. Fundin e fjalimit delegatet e pershndeten me thirrjet e skanduеme: „Tito-Partija", te cilat zgjaten disa minuta. Mandej delegatet e knduen Internacjonalen).

Kongresi pranoi njizanit rezolucionin ne lidhje me referatet e Komitetit Qendruer te PKJ

Mbas mbarimit te diskutimit ne lidhje me referatet e Komitetit Qendror te Partis Komuniste te Jugosllavis, te cilet i dhane shoket Tito, Aleksander Rankoviq dhe Millovan Gjillas, shoku Dushko Berkiq, kryetari i komisjonit per pruemjen e rezolutave, e lexoi propozimin e rezolucjonit, te cilin delegatet e Kongresit, me brohoritje enthuzjaste per Komitetin Qendror e pranuen njizanit.

Mbasi u-ndigjuen referatet mbi punen e deritashme te KQ te PKJ dhe diskutimi i gjane, Kongresi i Peste i PKJ aprovoi ket

REZOLUCJON

Kongresi i pranon ne tansi referatet e KQ te PKJ, te cilet i dhane shoket Josip Broz Tito, Aleksander Rankoviq dhe Millovan Gjillas.

Kongresi konstaton:

1) KQ i PKJ ne periudhen prej vitit 1937 deri ne Konferencen e Peste te vendit, mbajtun ne vitin 1940, e konsolidoi perfundimisht Partin t'one, tue e spastrue prej elementeve frakcioniste, antiparti dhe trockista, e perforcoi me kuadra te reja, sidomos nga radhet e klases puntore dhe e aftesoi qe, si tansi monolite, te bahet faktor politik ne Vendin t'one. Shprehje e ketij konsolidimi, uniteti dhe e lidhjes se forte me turmat punojse ka qene konferenca e peste e Vendit, qe ka pase randesi historike ne zhvillimin e Partis s'one.

KQ i PKJ ne krye me shokun Tito, ne tane veprimtarin e vet prej konferences se peste te Vendit deri ne Kongresin e peste te Partis Komuniste te Jugosllavis i ka krye plotsisht te gjitha detyret, qe jane parashtrue nga ngjarjet e mbrendshme dhe nderkombetare para Partis s'one dhe para KQ.

2) KQ i ka zbatue ne menyre konseguente vendimet e konferences se peste te Vendit, ne pikpamje te perforcimit te matutjeshem organizativ dhe politik te Partis s'one, e, ne saje te kesaj, Partija i priti ne menyre plotsisht te gatshme ngjarjet e mdha, qe erdhen mbas vitit 1940.

3) Me caktimin e drejte te vijes politike dhe me udheheqjen e drejte, nen udheheqjen e Komitetit Qendror, Partija ka muejte me u-lidhe ngushte me klasen puntore dhe me turmat punojse te Vendit t'one.

Si rezultat i kesaj lidhjeje me turmat dhe i besimit te turmave ne Partin dhe ne Komitetin e saje Qendror, Partija Komuniste e Jugosllavis luejti rolin vendimtar ne ditet e muejit mars te vitit 1941, kur u-rrexue qeverija trathtare Cvetkoviq Maçek, u-anulue hyemja e turpshme e Jugosllavis ne paktin tripalesh dhe nga popujt e Jugosllavis u-hoq njolla e madhe, te cilen jane perpjeke me ia hjedhe Vendit t'one dhe popujve t'one sundimtaret trathtare dhe profashista te Jugosllavis.

4) Ne katastrofen e Prillit te Jugosllavis se vjeter, ne kushtet ma te veshtira, Komiteti Qendror muejti me e ruejte kuadrin themelor te Partis, organizatat e Partis dhe tekniken e Partis. KQ i PKJ muejti qe per nji periudhe kohe aq te shkurte sa ka qene e mundun, me e preorjentue punen e Partis, e, me nji varg masash (Komiteti ushtarak etj.), me e ba t'afte per akcjone ne kushtet e okupacjonit fashist dhe me i caktue te tane Partis drejtimet e kjarta per luften e ardheshme, - per kryengritjen e armatosun.

5) KQ i PKJ ka pase qendrim te drejte kur, me ardhjen e okupimit te Jugosllavis, muer vendimin e vet historik per kryengritjen e pergjithshme te popujve te Jugosllavis. Tue iu-pergjigje thirrjes qe shoku Stalin ua drejtoi popujve te robnuem t'Europes me u-çue ne kryengritje kunder okupuesave gjermane dhe te tjere, KQ i PKJ e tregoi ne menyren ma te fuqishme besnikin e vet ndaj Bashkimit te madh Sovjetik, besimin e vet ndaj internacionalizmes.

6) Gjate luftes s'armatosun kater-vjeçare, Komiteti Qendror i kreu te githa detyret e parashtrueme, e çoi Partin dhe popujt t'one deri ke fitorja e plote mbi okupatoret dhe tradhtaret e popullit. Ne kete menyre, Partija e zgjidhi çashtjen themelore te revolucionit, -çashtjen e pushtetit. Partija Komuniste e Jugosllavis muejti me e shkpute Jugosllavin prej prangave t'imperijalizmit dhe, ne saje te rolit te BRSS ne lufte dhe mbas lufte, ne situaten e krijueme nderkombetare, iu ka ba te mundun popujve t'one me shkue n'udhen e trasnformimit socjalist.

Ky sukses historik asht mbrri me flijime te mdha. Kongresi i peste i perkujton me nderim te thelle te dhete antaret e Komitetit Qendror, qinda mija komunistat, skojistat dhe bijt e tjere te popullit t'one, qe rane heroikisht ne luften e armatosun per çlirimin e Vendit t'one.

7) Mbas çlirimit te Vendit, Komiteti Qendror muer masa te matutjeshme per forcimin organizativ, politik dhe ideologjik te Partis dhe e bani t'afte per zgjidhjen e detyreve te mdha ne lidhje me udheheqjen e shtetit, likuidimin e trashigimit te rande te luftes, rindertimin dhe ndertimin e Vendit, kalimin n'ekonomi me plan dhe mobilizimin e turmave perzgjidhjen e çashtjeve te mdha ne lidhje me ndertimin e socjalizmit. KQ i PKJ e shtroi drejte çashtjen e ndertimit te socjalizmit ne vendin t'one dhe i zgjidhi drejte te gjitha detyret e deritashme themelore te periudhes se kalimit prej kapitalizmit ne socjalizem.

8) Ne te gjitha çashtjet nderkombetare, -gjate lufte dhe mbas lufte - Komiteti Qendror ka ndjeke politike te drejte: deri ne çlirim-politiken e udheheqjes konseguente te luftes s'armatosun dhe te ndihmuemit te koalicjonit anti-hitlerjan ne krye me Bashkimin Sovjetik; mbas çlirimit- udheheqjen konseguente te politikes s'organizimit dhe te perforcimit te paqes, luften kunder nxitsave te luftes dhe perpjekjen e gjithanshme per forcimin e kampit anti-imperijalist ne krye me Bashkimin Sovjetik.

Ne baze te gjitha ketyne, Kongresi i peste i PKJ e pranon ne tansi vijen e deritashme politike dhe punen praktike te Komitetit Qendror te Partis Komuniste te Jugosllavis.

REZOLUCION

MBI DETYRET THEMELORE DHE T'ARDHESHME T'ORGANIZATAVE TE PARTIS

Ne baze te raporteve, referateve dhe diskutimeve tue u pranue ne tanesi dhe veç e veç si kritiken e gabimeve dhe te metave ashtu edhe detyret e Partis, te parashtruemë ne raportet dhe referatet, Kongresi i Peste e bjen kete REZOLUCJON:

MBI DETYRET THEMELORE DHE T'ARDHESHME T'ORGANIZATAVE TE PARTIS

Kongresi i Peste i PKJ parashtron para Partis keto detyre themelore per ndertimin e saje organizativ te matutjeshem:

1) me e sigurue me njihere zbatimin e Statutit te PKJ;

2) deri ne fund te ketij vjeti duhet te bahet mbajtja e kongreseve nacionale te Partis, ose e konferencave provincjale te PKJ per Bosnje e Hercegovine dhe Malin e Zi; konferencat provincjale te PKJ per Bosnje e Hercegovine dhe Malin e Zi me i trasformue ne kongrese themeluese t'organizatave te Partis se ketyne republikave. Ne lidhje me thirrjen e ketyne kongreseve me e ba zgjidhjen e te gjitha udheheqsinave te Partis, neper kongrese me i zgjedhe komitetet qendrore;

3) me e likuidue qendrimin sektash ndaj pranimit t'antareve te rij te Partis dhe me sigurue permirsimin e perbamjes sociale te Partis, tue marre nji kurs ma te guximshem per pranimin e puntorve ne Parti e ne radhe te pare te puntorve industrijal;

4) Per ruejtjen e bashkimit dhe te pastertis se Partis, me e mpref ma teper vigjilancen dhe me ashpersue luften kunder te gjitha shmangëjevet dhe elementeve te huej, armiqe, oportuniste dhe shpirt te vogjel ne Parti;

5) me i ngrite me guxim kuadrat e reja te aprovueme, ne pozitat udheheqese; me ba pune ma te gjane dhe me plan ne ngritjen e kultures se pergjithshme dhe ideo-politike t'antareve;

6) Me e perforcue luften per zhdukjen e praktiçizmit te ngushte nga puna e perditshme e organizatave te Partis, per kuptimin e drejte te tanesis dhe te perspektives se luftes per socjalizem;

7) me e zhvillue edhe ma teper kritiken dhe autokritiken ne Parti, si kusht dhe metode kryesore qe e siguron zhvillimin e drejte te Partis;

8) me i permirsue gjithnji metodat e udheheqjes tue perdorë ma teper plan dhe sistem, me ndanjen e drejte te kuadrave dhe me sigurimin e kontrollit per zbatimin e vendimeve te Partis;

9) me e perforcue punen ne ngritjen ideologjike te kuadrave.

II

DETYRET THEMELORE TE PROPAGANDES

Kongresi i Peste shtron para Partis keto detyre themelore ne punen ideologjike te Partis;

1) me e perforcue propogandën marksisto-leniniste ne Parti dhe ne turmat punuese e me kete rast me i kushtue kujdes te veçante studimit te doktrines marksiste-leniniste mbi ndertimin e shoqnis socjaliste. Duhet me e perforcue luften kunder çfaqjeve te deformimit ose revizjonit te marksizmit-leninizmit, kunder idealizmit, mistikes etj., çka ekziston veçanrisht neper shkolla.

2) me zhvillue punen sistematike ne studimin marksist-leninist te problematikes se vendit t'one. Prandej, duhet me organizue punen ne perpunimin dhe studimin e historis se Partis s'one te levizjes puntore te vendit t'one, historia se luftes Nacional-çlirimtare dhe problemeve te ndertimit te socjalizmit ne vendin t'one. Ket detyre duhet me e marre si nji para kusht ma te nevojshmin te ngritjes ideologjike te kuadrave te Partis dhe edukimit te turmave ne frymen e socjalizmit;

3) me ba lufte sistematike kunder influences s'anmike ne jeten kulturale, indiferentizmit ideologjik dhe artistik;

4) me punue ne zhvillimin e jetes shkencore, ne perforcimin e institucjoneve te tashme shkencore, dhe ne krijimin e te rejave, tue i mbledhe te gjithe puntoret pozitiv te shkences dhe me ju ndihmue ne punen e tyne;

5) me dhane ndihme te gjithanshme ideologjike per zhvillimin e letersise dhe te te gjitha degeve t'artit tue luftue kunder kuptimeve dhe tendencave dekadente dhe formale, tue luftue per ideologjin dhe kualitetin e nalte te letersis dhe artit pergjithsisht.

III

DETYRET THEMELORE NE LUFTE PER AKTIVIZIMIN E TURMAVE NE NDERTIMIN E SOCJALIZMIT DHE PER FORCIMIN E ORGANIZATAVE MASOVIKE.

1) Tue pase parasysh nevojen e aktivizimit te matutjeshem te turmave punojse ne lufte per socjalizem, ne lufte kunder mbeturinave te sistemit kapitalist te thyem dhe perballimin e veshtirsive ne rrugen e ndertimit t'one socjalist, Kongresi i Peste i Partis Komuniste te Jugosllavis parashtron sidomos keto dy detyre:

a) luften e vazhdueshme kunder te gjitha metodave byrokratike dhe tjera, qe e pengojne afrimin e turmave dhe zhvillimin e inisjatives se tyne ne ndertimin e socjalizmit;

b) zhvillimi dhe forcimi i gjithanshem i punes politike ne turma, ngritja dhe zhvillimi i vazhdueshem i vetdijes te turmave punojse;

2) Fronti Populluer duhet me u-zhvillue dhe perforcue ma tutje qe te mundet me i krye keto detyre te veta themolore:

a) punen politike ne masa, spjegimin e detyreve dhe te rrugeve ta ndertimit t'one socjalist dhe detyreve te luftes kunder mbeturinave te reaksjonit. Spjegimin e masave konkrete te pushtetit populluer ne ndertimin e socjalizmit, thyemjen e manevrave t'anmikut, demaskimin e elementave reakcjonar, te cilet jane fute n'organizatat e frontit, spjegimin e pozites politike nderkombtare dhe demaskimin e manevrave te reakcjonit imperjalist dhe te nxitsave te luftes, Lufte aktive politike kundra akcjoneve t'anmikut te socjalizmit, kunder luhatjes se disa shtresave te popullit punojes, zhvillimi i gjane, ne baze vullnetare per studimin e marksizmit-leninzmit, studimin e luftes s'one Nacjonal-çlirimtare, e te problemave te ndertimit t'one dhe te problemave te politikes nderkombtare;

b) aktivizimin direkt te turmave per ndertimin socjalist, zhvillimin e aksjoneve masovike te punes, ndihme kooperativizmit dhe lufte per realizimin e planeve bujqesore;

c) pjesmarrja e gjithaneshme e turmave ne punen e organeve te vendit te pushtetit populluer, zhvillimi i kritikes dhe i kontrollit se turmave punojese mbi punen e organeve shtetnore dhe mbi aparatin ekonomik;

3) para sindikatave shtrohet detyra qe te zhvillojne matutje qendrimin e ri te klases puntore dhe te turmave punojse, ne pergjithsi ndaj punes, me organizue gara socjaliste dhe me e ngrite punen sulmuese, me luftue per diciplinen punojse, per permirsimin e kualitetit te punes, per ruejtjen e pasunis se popullit prej dameve, per sistemin e drejte te rrogave, per shperbliminin e drejte, per realizimin e te gjitha te drejtave te puntorve, te cilat u takojne ne shtetin e popullit punojes, kunder deformimit dhe shkeputjes byrokratike te ketyne te drejtave, per plotsimin e planeve ekonomike dhe per permirsimin e standardit jetsuer, per punen e drejte neper sipermarrje, per zhdukjen e te gjitha te metave qe e pengojne procesin prodhues dhe plotsimin e planit, per ngritjen profesijonale, politike, ideologjike dhe kulturale te puntorve, per zhvillimin e gjithanshem te lidhjeve reciproke me levizjen sindikale te vendeve te tjera, sidomos me BRSS dhe vendet e demokracis popullore, per perforcimin e solidaritetit nderkombetar te klases puntore. Duhet me luftue kunder stilit administrativ ne pune dhe per zhvillimin e matutjeshem te demokratizmit ne organizatat sindikale;

4) deri ne fund te ketij vjeti me e ba shkrimjen e Rinis Popullore dhe te Bashkimit te rinis Komuniste te Jugosllavis n,ate menyre, qe ne lidhje me kushtet e ndryshueme te vendit, te ndryshohet programi i Rinis Popullore, te merret kursi vendimtar per ngritjen ideologjike dhe edukimin e drejte politik t'antarve te saje, e qe antaret e tashem te SKOJ-it, simbas vetive te tyne individuale, gradualisht dhe pa nxitim, para dhe mbas bashkimit te ketyne organizatave, te pranohen per kandidat dhe antare te Partis. Rinija popullore duhet te jete ne t'arthmen nji nga rezervat kryesore te Partis. Realizimi i ketij bashkimi duhet me na sjelle si perfundim bashkimin edhe ma te forte te rinis, grumbullimin e saje edhe ma te gjane dhe edukimin ma te vendosun ne frymen e marksizem-leninizmit.

Duhet me e vazhdue mobilizimin e rinis per ndertimin e socjalizmit ne vendin t'one, me e ngrite dashnin e saje per pune dhe krijim ne te gjitha deget e ndertimit t'one socjalist. Me e fute gjansisht rinin ne kooperativizmin bujqesor ne katund dhe ne luften aktive per transformimin kultural te katundit t'one. Duhet me e perforcue punen „e organizatave te rinis ne shkolla dhe ne fakultete, me qellim permirsimi te suksesit ne mesim, ne diciplinen shkollore dhe me qellim t'edukimit marksist-leninist te rinis;

5) FAG-un, ne pikpamje organizative, duhet me e ba ma elastik, te gjithmnyrshem dhe ma t'afert ne jeten e perditshme te grave punojse. Ne bashkpunim me organizatat e tjera, FAG-u duhet m' e perfshi sidomos turmen e grave te mbrapambetuna dhe pasive, me organizue dhe ndihmue zhvillimin e te tane sis temit te ndihmes per gruen puntore, e n'anen dhe me marre pjese bashke me organizatat e tjera masovike ne zhvillimin e kontrollit masovik dhe t'inspektimit populluer nga poshte.

IV.

DETYRET THEMELORE TE PERFORCIMIT DHE TE NDERTIMIT TE PUSHTETIT POPULLUER

Kongresi i Peste i PKJ parashtron para Partis keto detyre themelore ne perforcimin dhe ndertimin e pushtetit populluer:

1) m'u-perpjeke qe ne keshillat popullore te zgjidhen perfaqsuesit ma te mire te popullit punojes, si antaret e Partis, ashtu edhe antaret e tjere te Frontit Populluer, ma te vetedishmit per interesat e verteta te puntorve, te katundarve te vobekt dhe te puntorve te mundit;

2) Nga nji ane me nji mase te plote m'e ba te mundun kontrollin dhe pjesmarrjen e turmave punojse, ose te perfaqsuesve te tyne ne punen e kryesis shtetnore, e nga ana tjeter, m'e sigurue aftesin profesijonale t'aparateve te keshillave popullore;

3) paralelisht me e zhvillue dhe perforcue si lidhjen horizontale te disa degeve te kryesis shtetnore me keshillat popullore ekzekutive te vendeve, ashtu edhe lidhjen e tyne vertikale me udheheqsinat e nalta te kryesis shtetnore, d.m.th. simbas vijes se resorve. Te kta duhet me sigurue si udheheqjen e shpejte dhe direkte t'organeve te nalta te kryesis shtetnore, ashtu edhe udheheqjen direkte organizative dhe kontrollin e keshillave popullore;

4) Kujdes te vaçant me i kushtue ndertimit organizativ t'aparatit te keshillave popullore. Prej formave te ngushta organizative te deritashme me kalue ne forma ma te zhvillueme, sikurse jane drejtoratet, kryesit, drejtorit, seksjonet etj;

5) Ne resoret e ministris me luftue gjithnji kunder te gjitha çfaqjeve te formave te vjetra byrokratike t'udheheqsis. Me sigurue udhehqsi te vertete nga qendra me qellim te kryemjes sa ma te shpejte edhe ma te drejte te detyreve, por njikohesisht me sigurue inisjative prej se poshtmi dhe pjesmarrjen e turmave ne punen e kryesis. Njikohesisht me luftue kundra te gjitha çfaqjeve te partikolarizmit lokal, mos kuptimet dhe prishjet e principit unik te pushtetit t'one populluer;

6) me ba lufte ma te vendosun kunder te gjitha çfaqjeve te byrokratizmit ne te gjitha organet e pushtetit populluer dhe ne tane aparatin ekonomik dhe shoqnor;

7) Me i kushtue ma shum kujdes shpenzimit te kryesis shtetnore dhe kursimit te gjithanshem n'aparatin shtetnor; njikohesisht me zhvillimin e organeve te pushtetit populluer dhe te kalimit prej formave te ngushta organizative ne mà te persosunat, me luftue kunder byrokratizmit te panevojshem t'aparatit;

8) me e perforcue edhe ma teper punen e organeve kontrolluese te shtetit tue luftue per zbatimin e drejte dhe te perpiket te vendimeve dhe direktivave, kunder deformimit te tyne gjate perpunimit dhe zbatimit;

9) Kujdes te posaçem me i kushtue ndertimit te kuadrave, si edhe kujdesit per to, sidomos n'aparatin e keshillave popullore. Me e zhvillue ma tutje sistemin t'one zyrtar ne kete pikpamje, prej tij me u zhduke te gjitha shejat e „identifikimit" dhe me u dhane mundesi edhe ma te mdhaja per shperblimin ma te drejte te kuadrave te mira.

V.

DETYRET THEMELORE TE ZGJANIMIT DHE PERFORCIMIT TE MATUTJESHEM T'EKONOMIKES SOCJALISTE TE RFPJ.

Kongresi i Peste i PKJ konstaton se me qellim te zgjanimit dhe perforcimit te matutjeshem t'ekonomikes socjaliste te RFPJ parashtrohen para PKJ, organizatave masovike, aparatit shtetnuer dhe para popullit punojes te Jugosllavis keto detyre themelore:

1) lufte per realizimin e Planit Pesevjeçar, si hallke kryesore ne ndertimin e ekonomis socaliste;

2) Zgjanimi dhe forcimi me themel organizativ i sektorit socjalist t'ekonomis s'one, sidomos ne tregti, kalim ne organizimin e gjithanshem dhe te sinkoqitun te sipermarrjeve ekonomike, institutewe dhe t'aparatit shtetnuer ekonomik; perdorimi i metodave ma racionalizuese te punes; perpunimi i matutjeshem, pershtatja dhe perhapja e planifikimit, evidences dhe e statistikes; organizimi i gjithanshem i organeve per planifikim prej se nalti deri poshte;

3) Çfrytzimi konseguent dhe i gjithanshem i burimeve te landeve te para te vendit dhe te kapaciteteve te tashme per prodhimin e mjeteve te reja moderne per prodhim;

4) Zgjanimi i ri i prodhimtaris, shtimi dhe zgjanimi i ri i akumulimit socjalist;

5) ngritja e prodhimit te punes n'industri, ne ndertim dhe n'industrin e pyjeve etj.

6) organizimi sistematik dhe ndihma e hovit te racjonalizimit, te shpikjes dhe zbulimit, ne menyre masovike, ashtu dhe te specijalistave;

7) perforcimi i diciplines punojse dhe i qendrimit ne pune, rregullimi vendimtar i politikes se tarifes, mobilizimi i perpiket i fuqis se re puntore;

8) perforcimi dhe zgjanimi i pozitave socjaliste ne katund, ne radhe te pare me anen e perhapjes se forcimit organizativ dhe materjal te kooperativizmit bujqesor ne baze plotsisht vullnetare, furnizimin e tij me mjete moderne bujqesore, sigurimi me kredite shtetnore dhe me ndihmen e pergjitshme financjare. Perforcimi i punes se mbrendshme politike, lufta per pjesmarjen sa ma aktive te kooperativistave ne jeten e kooperatives, per parashtrimin dhe zgjidhjen e detyrve kolektivisht, per pegjegjesin e organeve kooperative dhe e nepunsave kooperativ ne mbledhjet kooperative para antareve te kooperatives, kunder byrokratizmit dhe zgjidhjes se detyreve mbrenda ne zyre, per inisjativen krijuese te turmave neper kooperativa, per planifikimin koshjent ne kooperativa dhe jasht kooperativave;

9) organizimi i gjithanshem, ndertimi kapital dhe zgjanimi i pronsive bujqesore te shtetit;

10) organizimi dhe shtrengimi i matutjeshem i elementave kapitalist ne katund; likuidimi i kapitalistave ne qytet;

11) Lufta sistematike dhe e gjithanshme per shtimin e prodhimit te bujqesis dhe per ngritjen e produktivitetit te punes ne te. Mobilizimi i industris s'one ne drejtim te prodhimtaris se shpejte dhe ma te gjane te veglave dhe maqinave bujqesore, te veglave t'imta bujpesore dhe te plehut artificjal;

12) ngritja e standardit jetsuer dhe permirsimi i furnizimit, organizimi sistematik i ekonomis, menzave etj. Lufta per burimet e reja te ushqimeve jetsore.

Rezolucjoni u pranue njizanit. Te gjihe delegatet e pershendeten pranimin e rezolucjonit tue u ngrite ne kambe, me duertrokitje frenetike dhe me thirrjen „Tito-Partija".

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit populluer — Shtypshkroja Krahinuer e Frontit Populluer. Pajtimet ne fletore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.